

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0508-A0001****Në ankesën e*****Paditësja/Ankuesja*****Z S**, Prishtinë,- e përfaqësuar nga avokate S K Prishtinë.***kundër******E paditura*****NSH "Auto Prishtina"** (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, Shkelzen Sylaj, Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-15-0673 të datës 16 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditëses është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së parë i DHPGJSK-së C-IV.-15-0673, i datës 16 gusht 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 29 prill 2015, paditësja kishte parashtruar padi në DHPGJSK, kundër të paditurës AKP-së, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën

13,390.00 euro, në emër të pagave të papaguara për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtor i NSH "Auto Prishtina" (në likuidim). Padiësja në padi ka theksuar se ka qenë e punësuar pranë NSH-së "Auto Prishtina" dhe se pala e paditur me shkresën me numër të protokollit 15373, ishte njoftuar për fillimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjes i cili ka filluar me datën 21.07.2014. Po ashtu është njoftuar edhe për anulimin e të gjitha kontratave të punës të cilat deri atëherë kanë qenë në fuqi. Më datën 12 qershor 2014 se bashku me të punësuarit e tjerë në ndërmarrje nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishin depozituar një regjistër e cila përmbante emrin dhe mbiemrin e secilit të punësuar në ndërmarrje, pagat mujore, akontacionet e marra nga NSH-ja, dhe pagat që kishin mbetur të paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014, dhe se regjistrin në fjalë me datën 12 qershor 2014, i'a kanë dorëzuar palës së paditur. Padiësja kishte theksuar se në mes të menaxhmentit, këshillit drejtues dhe sindikatës në njërën anë dhe ndërmarrjeve private me pronarë B S ishin krijuar raporte të dëmshme për NSH dhe se menaxhmenti në bashkëpunim me palën e paditur nuk kishin arritur t'i normalizojnë këto raporte, si rezultat i këtyre raporteve pala paditëse është dëmtuar me mos pagesë të pagave për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2017. Në vazhdimësi ka kërkuar kompensimin e pagave mujore sipas kontratës së punës deri në njoftimin në lidhje me procesin e likuidimit të ndërmarrjes. Pran Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë brenda afatit ku ka kërkuar kompensimin, mirëpo Autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave edhe përkundër faktit se kërkesa ka qenë e parashtruar brenda afatit dhe ka pasur prova të mjaftueshme. Padiësi në padi i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tersi si të bazuar kërkesën e tij dhe të detyrohet pala e paditur që palës paditëse t'ia paguajë borxhin-pagat e paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014 , në shumën e përgjithshme prej 13,390.00 euro me normë të kamatës prej 3.5 % në vit. Padiësja padisë i ka bashkangjitur: autorizimin për përfaqësim, numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80077394 të SH.A "Auto Prishtina", njoftimin drejtuar AKP-së për ushtrimin paditës kundër AKP-së, 2 njoftime të AKM-së drejtuar B S të vitit 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat për 130 muaj sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003 dhe librezën e punës.

Më 30 mars 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte lëshuar Urdhër C-IV.-15-0673, për paditësen ashtu edhe për AKP-në. Në Urdhrin për paditësen është kërkuar të plotësohet padia e ushtruar në lidhje me pagimin e pagave të pa paguara për periudhën e muajit tetor 2003 deri në muajin qershor të vitit 2014, dhe ju është kërkuar të sqarohet saktë në lidhje me pretendimin sipas saj se ka ushtruar kërkesë kreditore në procedurë të likuidimit pranë AKP-së. Po ashtu i është kërkuara të tregohen shkaqet e ankesës kundër vendimit, bazën juridike, provat me të cilat vërtetohen faktet.

Ndërsa në Urdhrin për AKP-në, është kërkuar të jep përgjigje në mbrojtje në padinë e paditëses dhe të dorëzon të gjitha provat në të cilat mbështeten argumentet.

Më 13 prill 2022, i autorizuari i paditëses kishte dorëzuar përgjigje ndaj Urdhrit me të cilin ishte deklaruar se paditësja në dosje të lëndës ka vendimin e N.SH-së "Auto Prishtina" dhe kishte bashkangjitur një vendim tjetër me nr. PRN 126-0120 të 29 prill 2015, me të cilin paditëses iu kishte pranuar kërkesa për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 487,32 euro, si dhe një pjesë të provave të cilat i kishte bashkangjitur me ankesë.

Më 21 prill 2022, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuar në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. E paditura theksoi se NSH, "Auto Prishtina" ka hyrë në procedurën e likuidimit më 21 korrik 2014, më datën 11 shtator 2014, pala paditëse pranë saj ka parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave në shumën prej 13,390.00 euro. Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRN126-0121, të datës 31 mars 2015, e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësi në atë procedure. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit e ka marrë vendimin për refuzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 36.2 1 Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe nenit 608 të ligjit për punën e Bashkuar (i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIKUT 199/24 është përcaktuar se pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë të

punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tri vite. E paditura kishte theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. E paditura thekson se pretendimet e paditësi janë parashkruar ngase nuk ka asnjë prove që para Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi ka dorëzuar kërkesë pranë gjykatës apo organit tjetër kompetent nga shtatori i vit 2003. AKP ka bashkangjitur vendimin e AL PRN126-0121, të datës 31 mars 2015, e ka refuzuar kërkesën për paga të paguara për periudhën tetor 2003 e deri në qershor 2014.

Më 11 maj 2015, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së përsëri kishte lëshuar Urdhër C-IV.-15-0673, për plotësimin e padisë në afatin prej 5 ditëve në lidhje me kërkesën për pagimin e pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003 deri në qershor të vitit 2014, në shumën prej 13,390.00 euro. Në urdhër po ashtu ishte theksuar se paditësja nuk kishte dorëzuar vendimin e AL me të cilin ishte refuzuar kërkesa për paga të paguara, nuk ishin treguar shkaqet e ankesës, baza juridike, provat që vetëtojnë lartësinë e shumes së kërkuar si dhe njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Me këtë urdhër i autorizuari ishte njoftuar me pasojën juridike të mos veprimit.

Më 27 maj 2022, i autorizuari i paditëses dorëzoi një parashtresë dhe ka theksuar se paditësja nuk e ka njoftimin për ndërprerjeje të marrëdhënies së punës dhe thekson se këtë e ka dorëzuar me padi.

Me 16 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktvendimin C-IV-15-0673, me të cilin hedhet poshtë si e pa pranueshme padia e paditëses, me të cilën ka kërkuar që e paditura t'ia paguajë borxhin për pagat e mbetura për periudhën tetor 2003- qershor të vitit 2014, në shumë 13,390.00 euro. Në arsyetim të këtij aktvendimi thuhet se padia e paditëses është hartuar në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit nr.06/L-086, sepse nuk është treguar ndaj cilit Vendim të Autoritetit të Likuidimit ushtrohet, ndërsa ashtu si është hartuar më shumë ka elemente të padisë së rregullt, se sa një padi kundër Autoritetit të Likuidimit me të cilin është refuzuar kërkesa kreditore, përkundër faktit se padia ishte ushtruar brenda afatit ligjor sipas nenit 37, paragrafi 7 i Shtojcës së Ligjitnr.04/L034, që rregullon kur Autoriteti i Likuidimit refuzon një kërkesë,

kreditore i prekur mund të kërkojë nga Gjykata brenda 30 ditëve të vendos për kërkesën e tij. Shkalla e I-rë ka theksuar se me rastin e hartimit të padisë në lidhje me kërkesën për paga të pa paguara për periudhën tetor të vitit 2003 deri në qershor të vitit 2014, në shumën e kërkuar 13, 960.00 euro, në padi nuk është treguar as numri, shenja dhe data e Vendimit të AL, pastaj nuk janë treguar shkaqet e ankesës, baza juridike provat me të cilat vërtetohen faktet e pretenduara (lista e dëmit). Në arsyetim të vendimit thuhet se Shkalla e I-rë për ti evituar të metat e parashtresës së padisë të paditëses, veprimi kryesisht, lëshoi Urdhrin ,C-IV.-15-0673, më 30 mars 2022, si dhe më 11 maj 2022, duke dhënë edhe udhëzimet në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr.06/L086 paditësja dhe i autorizuari i saj edhe pse e ktheu padinë në Gjykatë, ai nuk veprimi sipas udhëzime përkundër faktit se është njoftuar për pasojën juridike. Shkalla e I-rë ka konstatuar se padia e parashtruar për nga përmbajtja që është hartuar ka të meta për të cilat Gjykata kujdeset kryesisht, kështu që të njëjtën e hedhi si të pa pranueshme dhe zbatoi dispozitën nenit 36 paragrafi 2, pika 25. Lidhur me pikën 2.6 të Ligjit nr.06/L086, lidhur me nenin 102.3 të LPK-së.

Me 07 shtator 2022, nëpërmjet postës i autorizuari i paditëses e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0673 të datës 16 gusht 2022, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar, të aprovohet padia si e bazuar, ose ta prishë çështjen dhe të detyrohet e paditura t'ia paguaj paditëses borxhin për pagat e pa paguara për periudhën kohore tetor 2003- qershor të vitit 2014. Në ankesën e parashtruar pranë kolegjit të Apelit, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1 dhe par 2 pika n të LPK-së, nga se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit dhe shkresat e lëndës. Cenimi esencial i dispozitave të procedurës kontestimore konsiston edhe në faktin se vendimi ankimor përmban të meta të tilla për shkak të së cilave juridikisht është i paqëndrueshëm. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore

qëndron në faktin se vet e paditura me listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat sipas kontratës së punës të datës 12 qershor 2014 e kishte pohuar borxhin dhe ekzistimin e borxhit. Paditësja në ankesën e parashtruar konsideron se Shkalla e I-re në vendimin e saj të atakuar nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë as gjendjen faktike, pra nuk është vërtetuar fakti vendimtar se paditësja ka marrë vetëm akontacion të pagës e jo pagë të plotë të gjendjes faktike. Paditësja konsideron se për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur deri te aplikimi i gabuar i së drejtës materiale kur Gjykata e ka hedhur si të pa pranueshme kërkesëpadinë e paditëses. Gjykata e Shkallës së I-rë në rastin konkret gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenin 99 pika 2 të LPK-së nga se kërkesë padia i përmban të gjitha elementet e paraparë me këtë nen.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me nr.C-IV.-15-0673 të DHPGJS, pranë shkallës së I-re Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të ankesave që t'i referohet Mbrojtjes së aktvendimit përkatës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti anulohet dhe lënda kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me dt. 11 shtator 2014, kishte paraqitur kërkesë tek AL për kompensimin e pagave të paguara për periudhën tetor 2003 deri qershor 2014, në shumën prej 13,390.00 euro nga N.SH "Auto Prishtina" në (likuidim), por që kërkesa e saj ishte refuzuara për shkak të parashkimit sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (gazeta zyrtare RSFJ nr.53 të vitit 1976).

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 29 prill 2015 e kishte parashtruar padi në DHPGJSK, kundër të paditurës AKP-së, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën 13,390.00 euro, në emër të pagave të papaguara për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtor i NSH "Auto Prishtina" (në likuidim). Po ashtu Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesë ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim, numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80077394 të SH.A "Auto Prishtina", njoftimin drejtuar AKP-së për ushtrimin paditës kundër AKP-së, 2 njoftime të AKM-së drejtuar B S të vitit 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat për 130 muaj sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003 dhe librezën e punës.

Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktvendimin A-IV-15-0673 me të cilin e ka hedhur poshtë si e pa pranueshme padinë e paditëses, të parashtruar kundër vendimit të AL me të cilën ishte refuzuar kërkesa e paditëse që në emër të pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003 deri qershor 2014, t'ia kompensojë shumën prej 13,390.00 euro. Në arsyetim të këtij aktvendimi thuhet se padija e paditëses është hartuar në kundërshtim me nenin 35 të Ligjit nr.06/L-086, sepse nuk është treguar ndaj cilit Vendim të Autoritetit të Likuidimit ushtrohet, ndërsa ashtu si është hartuar më shumë ka elemente të padisë së rregullt, se sa një padi kundër Autoritetit të Likuidimit. Shkalla e I-rë ka theksuar se në padi nuk është treguar as numri, shenja dhe data e Vendimit

të AL, pastaj nuk janë treguar shkaqet e ankesës, baza juridike provat me të cilat vërtetohen faktet e pretenduara (lista e dëmit). Në arsyetim të vendimit thuhet se Shkalla e I-rë për ti evituar të metat e parashtresës së padisë të paditëses, veproi kryesisht, lëshoi Urdhrin ,C-IV.-15-0673, më 30 mars 2022, si dhe më 11 maj 2022, duke dhënë edhe udhëzimet në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr.06/L086 paditësja dhe i autorizuari i saj edhe pse e ktheu padinë në Gjykatë, ai nuk veproi sipas udhëzime përkundër faktit se është njoftuar për pasojën juridike.

Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi i Shkallës I-rë C-IV.-15-0673, i dt. 16 gusht 2022, me të cilin është hedhë poshtë si e pa pranueshme ankesa e paditëses është i gabueshëm ngase kërkesëpadia e paditëses ishte e qartë dhe mbështetur me prova. Kërkesëpadia e paditëses i përmban të gjitha elementet e pranueshmerisë së një kërkesë/ ankesa siç parasheh nenin 36 Ligjit për DHPGJS. Paditësja kishte kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën 13,390.00 euro, në emër të pagave të papaguara për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtore e NSH "Auto Prishtina" (në likuidim). Po ashtu nga padia vërehet qartë se paditësja e kundërshtonte vendimin e AL me të cilën e kishte refuzuar kërkesën e paditëses për paga të papaguara për periudhën tetor 2003 e deri në qershor 2014. Për me tepër edhe e paditura përmes mbrojtje së ushtruar me dt. 21 prill 2022 e kishte bashkangjitur vendimin e AL PRN126-0121, të datës 31 mars 2015, dhe në këtë aspekt ishte kontestuar kërkesa e paditëses pikërisht për periudhën dhe shumen e pagave të kërkuara, andaj urdhri i lëshuar nga Shkalla e I-rë me dt. 11 maj 2022, pasi që tani vendimi i AL-së PRN126-0121, gjendej në dosje të lëndës ishte i panevojshëm.

Kolegji i Apelit gjithashtu vëren se paditësja siç edhe kemi cekur më lart kishte bashkangjitur dëshmi të mjaftuara për tu trajtuara kërkesa në merita në Shkallë të I-rë dhe ne vazhdimësi i ishte përgjigjur urdhrin të Gjykatës, prandaj nuk bëhej fjalë për mosplotësim të kriterëve lidhur me nenin 35 dhe 36 të Ligjit nr. 06/L-086 të DHPGJS, në të cilën e ka bazuar Aktvendimin e saj Shkalla e I-rë e DHPGJS.

Bazuar në këtë gjendje faktike të identifikuar si më lartë, ankesa e paditëses është aprovuar si e bazuar, anulohet aktvendimi i ankimuar dhe lënda kthehet në rigjykim në Shkallë të I-rë tek gjyqtari përkatës.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 shtator 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.Sc, Sahit Syleamani Gjyqtar kryesues
